VENDIM
Nr 153, datë 29.12.2014

PËRFILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË "DEVOLL HIDROPOWER" SHA, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "a"; 9 dhe 13 pika 1, germa "d" të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar,neneve 4, pika 1, germa "g"; 5 pika 2; 8, 10/3;të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa "a", të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë(ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.12.2014, pasishqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Devoll Hidropower" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë sëLicencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Devoll Hidropower" sh.a. plotësonkërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Neni 9, pika 1. Formati i aplikimit është plotësuar nëmënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësoreshtë i plotësuartërësisht.
- Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskalështë i plotësuartërësisht.
- Neni 9, pika 4/10.Germa "a", germa"b", germa"c" është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Devoll Hidropower" sh.a.,për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komsionerëvetë ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti